


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERE MAJLINDA E. DEMOLLARI

Nr Rep

Nr Kol

6471

1763



STATUT E AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“HEALTH TECHNOLOGY LIMITED” SH.P.K TIRANË

Në Tiranë, sot më 04/07/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Noteres Majlinda E. Demollari, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, në Rr “Vaso Pasha”, u paraqitën personalisht:

1. **Hsing–Hua Huang**, i datëlindjes 29.04.1965, lindur në Taipei dhe banues në 8F, No.178-7, Songde Rd., Xinyi Dist., qyteti Taipei 110, Taivan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 306635272, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr.112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.
2. **Tzu-Ching Liang**, i datëlindjes 10.10.1966, lindur në Taipei dhe banues në No.75, Wudianxueshan 1st Vil., Dongqi Rd., Dongshi Dist., qyteti Taichung 423, Taivan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 301962180, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr. 112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.
3. **Kin Wai Hung**, i datëlindjes 19.03.1959, lindur në Guangdong dhe banues në Room 602, 6/F, Finance Bldg., 254 Des Voeux Rd C, Central Hong Kong, shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. KJ0529627, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr. 112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.
4. **Ching-Pang Pien**, i datëlindjes 27.08.1971, lindur në Taipei dhe banues në Nr 380, Xinyi Road, Linkou, New Taipei, Taivan, shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 309467490, i përfaqësuar me prokurë të

posaçme me Nr. 112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.

5. **Tzu-Yang Lin**, i datëlindjes 30.01.1987, lindur në Taipei dhe banues në Nr.1, Ln. 92, Guangzhou St., Wanhua Dist., qyteti Taipei 108, Taiwan (R.O.C), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 300987829, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr.112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.
6. **Tzu-Jen Chang**, i datëlindjes 04.02.1987, lindur në Taipei dhe banues në 3F., No.63, Dahua 1st Rd., Qidu Dist., qyteti Keelung 206, Taiwan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 216713827, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr. 112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.
7. **Hon Ying Li**, e datëlindjes 27.05.1984, lindur në Shanghai dhe banuese në Flat B, 11/F, Tower 8, 8 Laguna Verde Avenue, Laguna Verde, Costa Del Sol, Hung Hom, Kowloon, Hong Kong, shtetase kineze, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasaportë me Nr. K02665926, e përfaqësuar me prokurë të posaçme me Nr. 112674 datë 22.05.2018 nga Abdulah Tajari, i biri i Miftarit, i datëlindjes 06.03.1982, lindur ne Tetovë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën maqedonase me Nr. H0290742.

Në cilësinë e ortakëve të shoqërisë Shpk të cilët kanë vendosur të miratojnë dhe të nëshkruajnë statutin në përputhje me kushtet si më poshtë:

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1 - EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Health Technology Limited” sh.p.k** më poshtë e quajtur “Shoqëria”. Ky emërtim do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 2 - SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Sami Frashëri”, Kompleksi T.I.D, Shk. B, Kati 1, 10000, Tiranë, Shqipëri.

Më vendim të organit administrativ Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 - KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, duke nisur nga regjistrimi i saj pranë Regjistrimit Tregtar.

NENI 4 - OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt:
Prodhimin e ushqimeve kurative.

KAPITALI – PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortakët themelues:

- **Hsing-Hua Huang**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 18.000 lekë që përbën 18.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Tzu-Ching Liang**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 18.000 lekë që përbën 18.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Kin Wai Hung**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 18.000 lekë që përbën 18.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Ching-Pang Pien**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 12.000 lekë që përbën 12.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Tzu-Yang Lin**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 12.000 lekë që përbën 12.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Tzu-Jen Chang**, zotërues i një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 12.000 lekë që përbën 12.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Hon Ying Li**, zotëruese e një (1) kuotë kapitali, me vlerë të përgjithshme 10.000 lekë që përbën 10.00 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme ose të drejta).

5.3 Ortaku ka pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 6

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrimin Tregtar të kësaj qendre.

Ushtrimin e aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatimit dhe Taksave, Tiranë.

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

NENI 8

Asambleja e Ortakëve dhe administratori i shoqërisë, ka të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke lidhur kontratë sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Ri të Punës në fuqi dhe me ligjin Nr .7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore” të ndryshuar si dhe në përshtatje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vetë punëdhënësi.

NENI 9 - ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet me vendim të ortakëve, në përputhje me mënyrën dhe afatet për këtë zmadhim.
- 9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, ortakët kanë të drejtën e parapëlqimit ndaj shumave të emëtuara rishtazi. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet nga ortakët brenda 30 ditëve në raport me kuotat e kuotave që kanë në zotërim.
- 9.3 Ortakët që ushtrojnë të drejtën e parapëlqimit kur bëjnë kërkesë për ushtrimin e saj, kanë të drejtë parablerjeje për kuotat e parapëlqyera.
- 9.4 Cdo Ortak zotëron të drejtën të parablejë një numër më të vogël kuotash, pas aprovimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 10 - ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 10.1 Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet, në përputhje me ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare.
- 10.2 Zvogëlimi i kapitalit nuk mund të bëhet nën minimumin e parashikuar në ligj.

NENI 11- SHITJA E KUOTAVE

- 11.1 Në përputhje me kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, shitja e kuotave të kapitalit themelor i nënshtrohet në çdo rast të drejtës së parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë.
- 11.2 Për këte arsye, ortakët duhet të venë në dijeni ortakët e tjerë me letër rekomande me përgjigje, duke përcaktuar shumën e ofruar dhe kushtet e pagesës dhe emrin e blerësit.
- 11.3 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e letrës, ortakët e tjerë mund të vendosin të blejnë kuotën që është në shitje duke informuar shitësin mbi vendimin e tyre. Nëse të drejtën e parablerjes dëshiron ta ushtrojë më shumë se një ortak, secili do të realizojë blerje në përpjestim me kuotën që zotëron.
- 11.4 Kur blerësi nuk merr njoftim brenda tridhjetë ditëve, atëherë do të kuptohet se është hequr dorë nga e drejta e parablerjes.
- 11.5 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rastet e shitjes së kuotave nga një ortak tek një tjetër.

NENI 12 - ORTAKËT

12.1 Ortakët e Shoqërisë janë :

1. **Hsing-Hua Huang**, i datëlindjes 29.04.1965, lindur në Taipei dhe banues në 8F, No.178-7, Songde Rd., Xinyi Dist., qyteti Taipei 110, Taivan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 306635272.
2. **Tzu-Ching Liang**, i datëlindjes 10.10.1966, lindur në Taipei dhe banues në No.75, Wudianxueshan 1st Vil., Dongqi Rd., Dongshi Dist., qyteti Taichung 423, Taivan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 301962180.
3. **Kin Wai Hung**, i datëlindjes 19.03.1959, lindur në Guangdong dhe banues në Room 602, 6/F, Finance Bldg., 254 Des Voeux Rd C, Central Hong Kong, shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. KJ0529627.
4. **Ching- Pang Pien**, i datëlindjes 27.08.1971, lindur në Taipei dhe banues në Nr 380, Xinyi Road, Linkou, New Taipei, Taivan, shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 309467490.
5. **Tzu-Yang Lin**, i datëlindjes 30.01.1987, lindur në Taipei dhe banues në Nr.1, Ln. 92, Guangzhou St., Wanhua Dist., qyteti Taipei 108, Taivan (R.O.C), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 300987829.
6. **Tzu-Jen Chang**, i datëlindjes 04.02.1987, lindur në Taipei dhe banues në 3F., No.63, Dahua 1st Rd., Qidu Dist., qyteti Keelung 206, Taivan (R.O.C.), shtetas kinez, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë me Nr. 216713827.
7. **Hon Ying Li**, e datëlindjes 27.05.1984, lindur në Shanghai dhe banuese në Flat B, 11/F, Tower 8, 8 Laguna Verde Avenue, Laguna Verde, Costa Del Sol, Hung Hom, Kowloon, Hong Kong, shtetase kineze, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasaportë me Nr. K02665926.

- 12.2 Ortakët, në përputhje me legjislacionin shqiptar marrin vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) transferimin te të tretët e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve si dhe me emërimin e shkarkimin e ekspertit(eve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si dhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shpërndarjen e likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit (eve) e çdo vendim tjetër që sipas ligjit apo këtij statuti i takon Asamblesë së Ortakëve.

NENI 13 - ASAMBLEJA E ORTAKËVE

1. Funkzioni dhe Përgjegjësitë

Asambleja e Ortakëve do të mbledhet duke respektuar ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare dhe secili nga këto vendime do të respektojë statutin e shoqërisë, në lidhje me administrimin, marrëdhëniet me shoqëri të tjera, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit transferimin e kuotave, për emërimin dhe zëvendësimin e Administratorit dhe Personave të Autorizuar, aprovimin e bilancit të parashtruar nga Administratori, shit-blerjen e asetëve të shoqërisë si dhe çdo vendim tjetër i cili duhet t'i parashtrohet Asamblesë së Ortakëve.

2. Mbledhja vjetore e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Në këtë mbledhje të Asamblesë do të aprovohen nga ortakët raporti financiar i bilancit i aprovuar nga Administratori mund të vendosi edhe çështje të tjera të parashikuara. Mbledhjet e Asamblesë mund mbahen me conference-call.

3. Asambleja

Asambleja e Ortakëve mund të mbledhet në mënyrë të rregullt, siç parashikohet në dispozitat ligjore nga Administratori apo në mungesë të tij nga një Auditor i Autorizuar si dhe me kërkesën e një apo disa ortakëve që përfaqësojnë 10% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë.

4. Vendi i Asamblesë

Asambleja mund të mbledhet në vendin e caktuar nga Ortakët dhe nëse nuk do të përcaktohet një vend tjetër, vendi ku do të mbledhet Asambleja do të jetë selia e shoqërisë.

5. Njoftimi i Asamblesë

Administratori iu njofton të gjithë ortakëve, Mbledhjen e Asamblesë, me letër rekomande, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes. Lajmërimi përmban datën, adresën e vendtakimit dhe rendin e ditës së Mbledhjes. Njoftimi do të bëhet në adresën e regjistruar në Statut (Neni 5), nëse Ortaku nuk ka deklaruar një adresë të re.

6. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja merr vendim me shumicë të zakonshme në rast se nuk do të kërkohet ndryshe në këtë Statut apo në ligj. Në rast se shumica e zakonshme është e kërkuar, nuk është e pranishme, Asambleja do të vendosi një tjetër datë për mbledhjen e saj. Njoftimet do të behen sipas paragrafit 5 të këtij Neni. Në mbledhjen e dytë të thirrur Vendimet do të jenë të vlefshme vetëm me shumicën e votave të Ortakëve që përfaqësojnë totalin e kapitalit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një votim i ndryshëm në Statut apo në ligj.

7. Autorizimi

Ortakët mund të Autorizojnë me shkrim një person tjetër për të votuar në vend të tij duke përfaqësuar kuotat e poseduara prej tij. Kryetari i mbledhjes do të jetë përgjegjës për tu informuar në lidhje me rregullsinë e autorizimit dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në mbledhjen e Asamblesë.

8. Pranimi me shkrim

Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, do të jenë në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

NENI 14- ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

14.1 Shoqëria administrohet nga 1(një) Administrator **Abdulah Tajari, me afat 5 vjeçar.**

14.2 **Administratori do të veprojë dhe do të firmosë** pa asnjë kufizim, përfshirë edhe çdo veprim bankar, të përfaqësojë shoqërinë përpara çdo autoriteti tatimor, doganor si dhe institucioneve të tjera Shqiptare.

14.3 Në zbatim të këtij neni, administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë pa asnjë kufizim kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, duke përfshirë këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajnë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak si dhe ndryshimin e statutit të tyre, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqjeje e derdhje shumash nga këto llogari veç e veç dhe pa limit.

14.4 Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që i konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Asamblesë se Përgjithshme të Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

14.5 Administratori emërohet për një periudhe kohore 5 vjeçare, me të drejte ripërtëritjeje, dhe është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.

NENI 15

15.1 Administratorit u takon t'u paguhen shpenzimet e bëra për shkaqe të detyrës së tij.

15.2 Asambleja mund t'u njohë atij një kompensim vjetor.

NENI 16

16.1 Administratori apo Drejtori i Përgjithshëm nëse është i emëruar, do të përfaqësojë shoqërinë me palët e treta gjatë gjykimeve, ka të drejtën e emërimit të avokatëve, juristëve, në kufinj të përgjegjësive të lejuara.

NENI 17 - KONTROLLI KONTABËL

17.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakëve do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 18 - FINANCIMI I SHOQËRISË

18.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga Asambleja e Ortakëve financime të mëtejshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, të ndryshme nga zmadhimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë.

18.2 Financimet e mëtejshme të Asamblese së Ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

18.3 Asambleja ka te drejtë të vendosi në çdo kohë në lidhje me rezervat dhe sasinë e tyre.

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 19 -VITI FINANCIAR

19.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë, i cili fillon nga data e regjistrimit dhe mbaron në fund të vitit.

NENI 20- LLOGARITE VJETORE

20.1 Llogaritë vjetore, raporte mbi operacionet e veprimtarisë lidhur me vitin financiar dhe raportet e veçuara të hartuara nga administratori dhe nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicën e zakonshme.

20.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

NENI 21 - FITIMI

21.1 Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lenë rezervë për nxitje ekonomike, për investime për reklame tregtare, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit themeltar që ka secili ortak.

21.2 Ortakët e huaj, mund të transferojnë lirisht fitimet e realizuara jashtë shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

NENI 22 - BILANCI

22.1 Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUIDIMI

NENI 23

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë:

- A) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- B) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “Për falimentimin e Shoqërive Tregtare”
- C) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilën parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në Likuidim e sipër”.

NENI 24

Shoqëria duhet të kryejë procesin e likuidimit në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

NENI 25

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar pranë QKB.

NENI 26

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizik apo juridik, vendas apo të huaj.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 27-KONFLIKTET

Të gjitha mosmarrëveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të shqyrtohen nga gjykata e rrethit Tiranë.

NENI 28

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet udhëzimeve plotësuese dhe të ligjshme të dhëna nga Asambleja e Ortakëve si dhe legjislacioni në fuqi.

NENI 29

Ky statut u redaktua në 9 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale, autenticiteti i të cilës vërtetohet nga Noteri.

ORTAKËT

Të Përfaqësuar me prokurë nga

ABDULAH TAJARI

Abdulah Tajari
